



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 19/1 Prot.

Tiranë, më 10/01/2012

Lënda: Rekomandim për "Qëndrën Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 10/01/2012

Mbështetur në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe Nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 04/11/2011, nga grupi i kontrollit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, "Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

1-Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";

2-Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë autoritetit të Komisionerit, në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21);

3-Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni27);

4-A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese.

Komisioneri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara, vëren se:

1. Kontrolluesi Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Komisionerit sipas nenit 21 i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale".

Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

2. Kontrolluesi, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë nuk ka hartuar dhe nuk zbaton një Rregullore të brendshme të hartuar prej tij lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në zbatim të neneve 27/2 "c", të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Moskryerja e këtij detyrimi ligjor përbën shkelje të kërkesave të nenit 27/2/c të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"; "Kontrolluesi, udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave".

3. Kontrolluesi, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr.1", Tiranë në rast nxjerrje jashtë përdorimi, të kompjuterave, duhet të shkatërojë njësitë hard-disk të PC-ve të për të pamundësuar rikuperimin e çdo informacioni që mund të gjendet në to, në mbështetje të neneve 5, 6, 7, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Për sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Bazuar në nenet 21-22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të realizoni pranë Komisionerit njoftimin për përpunimin e të dhënave personale për të cilat jeni përgjegjës, brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh;
2. Bazuar në nenet 27/2 "c" dhe 28 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të hartoni Rregullore të Brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh;
3. Bazuar në nenet 5, 6, 7, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", në rast nxjerrje jashtë përdorimi të kompjuterave, të shkatëroni njësitë *hard-disk* të PC-ve, për të mos bërë të mundur rikuperimin e çdo informacioni që mund të gjendet në to, brenda një afati prej 20 (njëzet) ditësh;
4. Me kalimin e afateve, në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 39, "Kundërvajtjet administrative", të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

